



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



FFDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA  
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO

Nr. 487 Dt. 16.09.2021  
PRISHTINË • PRIŠTINA • PRISTINA

**UDHËZUESI  
PËR  
ZHVILLIMIN E GARAVE TË BASKETBOLLIT  
NË  
REPUBLIKËN E KOSOVËS**

**16.09.2021, Prishtinë**



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## 1. HYRJE

Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK) duke u bazuar në Vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e Pandemisë Covid-19 e ka përgatitur Udhëzuesin për Zhvillimin e Garave të Basketbollit në Republikën e Kosovës.

**Të gjithë akterët e regjistruar si persona zyrtarë nga klubet dhe personat e angazhuar në organizim të ndeshjeve në kuadër të Federatës së Basketbollit të Kosovës duhet të paraqesin vërtetimin e vaksinimit (me së paku 1 dozë) deri më 15 tetor 2021, respektivisht me 2 doza deri më 15 nëntor 2021.**

## 2. PRANIA E SHIKUESVE NË PALESTRAT SPORTIVE

- Lejohet prania e shikuesve konform Vendimit në fuqi të Qeverisë së Republikës, duke respektuar masën e distancës 1,5 metra, vendosjen e maskës (mbi hundë) dhe ulëset 1 në 3 ulëse. Pra kufizimi i numrit të pjesëmarrësve në ndeshjet e basketbollit do të jetë ai i percaktuar nga autoritetet kompetente të Republikës së Kosovës.
- Shikuesit në palestrat sportive duhet të posedojnë një nga dëshmitë e cekura më poshtë:

- 2.1 **Certifikatën e vaksinimit për vaksinimin e plotë ose marrjen e një doze të vaksinës kundër COVID-19.**
- 2.2 **Testi RT-PCR negativ për COVID-19, jo më i vjetër se 72 orë.**

Klubi nikoqir i ndeshjes (organizatori) obligohet edhe sipas Propozitioneve të Garave të ofrojë Komesarin e Sigurisë për ndeshje, si dhe të sigurojë forca policore të mjaftueshme për të kontrolluar që shikuesit mund të hyjnë vetëm me dëshmitë e lartëpërmendura.

Federata e Basketbollit të Kosovës nëpërmjet Komisionerit për Covid-19 ka të drejtë të mbikëqyrë procedurën e hyrjes së shikuesve në palestër.

Shikuesit do të lejohet të hyjnë në palestër 30 minuta para ndeshjes, ndërsa dyert do të mbyllen 10 minuta para fillimit të ndeshjes.

Federata e Basketbollit të Kosovës për çdo ndeshje do të emërojë Komisionerin për Covid-19, i cili në koordinim me Komesarin e Sigurisë dhe Policinë e Republikës së



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Kosovës do të jenë përgjegjës për kontrollimin e posedimit të ndonjërs nga dëshmitë sipas pikës 1 dhe 2, si dhe të ndërmarrin masat specifike, në përputhshmëri me protokollet ndërkontaktive për menaxhimin e massës (tifozëve) para, gjatë dhe pas hyrjes në hapësirën sportive. Kjo vlen për shikuesit në palestër, për akterët e ndeshjes, dhe zyrtarët e ekipeve pjesëmarrëse në ndeshje, dhe zyrtarët e tjerë të pranishëm, duke përfshirë këtu edhe zyrtarët e Federatës së Basketbollit të Kosovës (Bordi, Zyra Ekzekutive, etj).

### 3. MASAT PARANDALUESE

- Të gjithë akterët e ndeshjeve të basketbollit, duke përfshirë këtu basketbollistët/et, personat zyrtarë të ndeshjeve dhe zyrtarët e ekipeve obligative e kanë të jenë të jenë të vaksinuar kundër Covid-19 dhe dëshminë e vaksinimit duhet ta dorëzojnë para çdo ndeshje tek Komesari Covid-19.
- Matja e temperaturës të bëhet tek të gjithë anëtarët e klubeve para hyrjes në palestrën e sportit nga mjeku kujdestar i klubit, vëzhguar nga Komisioneri për Covid-19. Temperatura normale e trupit për secilin duhet të jetë nga 36 deri 37° C. Anëtarët e klubit të cilët kanë temperaturë të trupit nga 37.1 dhe 37.2 duhet të izolohen në një hapësire të ndarë për 15-20 minuta. Pas pritjes së kohës së lartpërmendur ndaj anëtarëve duhet të bëhet përsëri matja e temperaturës. Në rast të zbritjes së temperaturës këtyre anëtarëve u lejohet hyrja në sallën e sportit, në të kundërtën të njëjtë duhet të largohen nga palestra e sportit. Anëtarët të cilët kanë temperaturë trupore 37°3 dhe më të lartë nuk u lejohet hyrja në palestër dhe për këtë njoftohet klubu dhe i njëjti duhet të izolohet nga udhëtimi i përbashkët me anëtarët e tjerë të klubit.
- Vendosja e mjetave dezinfektuese të cilat përbëjnë 70% alkool për dezinfektimin e duarve në vende të caktuara para fillimit të ndeshjes.
- Përdorimi i maskave nga të gjithë anëtarët, trajnerët dhe lojtarët, të cilët nuk janë të pranishëm në fushën e lojës.
- Secili lojtar duhet të ketë pajisjet e veta personale.



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

- Secili klub është i detyruar të sigurojë sasi të mjeteve dezinfektuese, si dhe të sigurojë maskat për të gjithë anëtarët e saj.
- Të mbajnë distancën sociale (të mos ketë përshëndetje me duar, përqafime dhe çfarëdo kontakti tjeter).

#### **4. MASAT E PËRGJITHSHME TË KUJDESIT**

- Të largohet ushqimi në zhveshtore.
- Të ketë kujdes vendosja e pajisjeve personale në vende të përbashkëta ose në çanta sportive të përbashkëta.
- Të bëhet hedhja e fashave, flasterëve etj në shportën e mbeturinave e cila duhet të jetë e mbyllur.
- Të bëhet pastrimi i duarve më së paku deri 20 sekonda, si dhe pastaj të bëhet tharja e duarve me letër të një përdorimi. Nëse do të ketë mungesë të ujit ose sapunit është obligative të bëhet përdorimi i mjeteve dezinfektuese me përbërje deri në 70 % alkool.
- Pas përdorimit të tualetit është obligativ pastrimi i duarve me sapun dhe tharja e duarve me letër për një përdorim.
- Të shmanget prekja e syve, hundës dhe veshëve me duar të papastras.
- Mbuloni hundën/gojën me pallomë ose me bërryl në rast se teshtini ose kolliteni.
- Duhet të bëhet dezinfektimi i rregullt i tavolinës zyrtare, ulëseve, bankinave, zhveshtoreve, dush kabinave, tualeteve me mjete dezinfektuese siç janë klori, tretës, etanol 75% dhe kloroform.



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

- Mjeku i klubit duhet të përcjellë situatën shëndetësore të lojtarëve dhe anëtarëve të klubit, duke ua matur temperaturën trupore për të gjithë anëtarëve të klubit. Mjeku i klubit duhet të mbajë një evidencë për të gjithë anëtarët e klubit me të dhënat nga temperatura trupore, dhe që të sigurohet se gjatë stërvitjes/ndeshjes nuk ka lojtarë të sëmurë.
- Të gjitha zhveshtoret dhe dhomat tjera përcjellëse të jenë në kushte të mira higjenike.
- Para hyrjes në palestrat e sportit duhet të vendosen mjetet dezinfektuese për duar dhe të bëhet matja e temperaturës trupore.
- Në sallat e sportit me kapacitete të mëdha duhet të sigurohet distanca fizike.

- Gjatë zhvillimit të ndeshjes, ekipet e televizioneve, përfaqësuesit e mediave, vullnetarët gjatë gjithë kohës së qëndrimit në palestër duhet të bartin maskat (mbi hundë).

## 5. MASAT GJATË KOHËS SË ZHVILLIMIT TË STËRVITJEVE

- Të gjithë pjesëmarrësit në palestrën e sportit duhet të jenë të identifikuar.
- Fusha/hapësira e stërvitjes duhet të jetë qartë e definuar për lojtarët, trajnerët dhe personat tjerë përcjellës dhe personat tjerë të mirëmbajtjes për pastrim dhe dezinfektim.
- Dezinfektimi dhe mirëmbajtja e objekteve duhet të bëhet me pëlqimin e organeve kompetente.
- Mbrojtja, higjiena dhe pastrimi i duarve duhet të jetë në nivelin më të lartë.
- Të gjitha stërvitjet të cilat kanë numër të madh të pjesëmarrësve duhet të shkojnë me pjesëmarrës në minimum.



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

- Në stërvitje mund të jenë të pranishëm vetëm pjesëmarrësit të cilët janë të obliguar në pjesëmarrje të stërvitjes. Ata duhet të jenë në regjistrin e klubit dhe të jenë të identifikuar me: emri, mbiemri, vendi i punës (lojtar, trajner, ekonom, fizioterapeut) dhe data e mbajtjes së stërvitjes.

## 6. PALESTRAT E SPORTEVE

- Para hyrjes së sportistëve, palestra duhet të jetë thellësisht e pastruar dhe e dezinfektuar me pëlqimin e organeve kompetente.
- Të gjitha hapësirat kritike duhet të jenë të dezinfektuara (dyert, bravat e dyerve, prizat).
- I gjithë procesi duhet të jetë në formë të shkruar (protokolli i dezinfektimit të palestrës, dita dhe data) dhe që palestra është zonë e sigurt.
- Të gjithë personat që kanë qasje në palestër duhet t'i përbahen kushteve higjenike.
- Tavolina zyrtare duhet të ketë mbështjellës nga Plax Glas.
- **Ekonomi i klubit** duhet të punojë në një dhomë të ndarë dhe gjatë gjithë kohës të mbajë maskën.
- Sa herë që ekonomi prek pajisje tjera i njëjti duhet t'i pastrojë duart.
- **Fanellat:** Lojtarëve duhet tu dorëzohen dy komplete të fanellave dhe të njëjtat pas çdo ndeshje duhet të pastrohen në shtëpi.
- Personat e autorizuar për mirëmbajtje të palestrës duhet të bartin maskat dhe dorëzat.
- Tualeti duhet të jetë thellësisht i pastruar dhe i dezinfektuar.



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

- Shportat e mbeturinave duhet të jenë të vendosura sa më larg që është e mundur.

**- Fizioterapeuti:**

- Mjekon vetëm lojtarët e lënduar.

- Fizioterapeuti gjatë gjithë kohës duhet të bartë maskën dhe dorëzat me vete.

- Maska e re dhe dorëza të reja duhet të zëvendësohen nga fizioterapeuti pas çdo mjekimi të lojtarit.

- Tavolina e masazhës duhet të jetë e mbuluar me letër për një përdorim, e cila duhet të largohet menjëherë pas përdorimit.

- Personalisht duhet të kujdeset për higjienën e tij pas dhënieve së tretmanit të lojtarit.

- Pas përdorimit të çdo pajisje të fitnesit të njëjtat duhet të dezinfektohen me letër për një përdorim.

**- Hapësirat e fitnesit** duhet të reduktohen në minimum dhe të jetë e kufizuar hapësira dhe numri i lojtarëve.

- Të vendosen mjetet dezinfektuese para hyrjes së fitnesit.

- Në kohën e njëjtë të stërvitjes mund të ketë 1 ose 2 lojtarë në hapësirën prej 2 metrave.

- Dritaret duhet të jenë të hapura gjatë gjithë kohës, ose klimatizimi duhet të jetë i kyçur.

- Nëse është e mundur asnjë trajnerit nuk duhet t'i lejohet qasja në fitnes, por nëse është obligative pjesëmarrja e trajnerit, atëherë lejohet vetëm me bartjen e maskave.



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

- Në fund të ushtrimeve për çdo ditë duhet të bëhet dezinfektimi i hapësirës së ushtrimeve.

## 7. TRANSPORTI

- Në rast se ekipi udhëton me autobus apo minibus, lojtarët dhe stafi që janë në mjetin e transportit duhet që gjatë gjithë kohës të kenë maskën e vendosur (mbi hundë) dh dhe çdo e dyta ulëse duhet të jetë e lirë.
- Gjatë transportit me autobus/minibus duhet të mbahet distanca prej 1.5 m si dhe para udhëtimit mjeti transportues duhet të jetë i dezinfektuar.

## 8. MASAT MBROJTËSE GJATË KOHËS SË ZHVILLIMIT TË NDESHJES

- Të ketë ujë të pijshëm për secilin lojtar, individual (shishe plastmase ose të qelqit) dhe të mos konsumohet uji nga krojet.
- Të mos ketë prekje të fytyrës gjersa lojtarët janë në kontakt me topin.
- Të mos ketë ndarje të ushqimit e piyeve ndërmjet lojtarëve dhe stafit tjetër mbështetës të ekipit.
- Në ulëset e klubit duhet të ketë mjete për dezinfektim të lojtarëve dhe përcjellësve të klubit.
- Lojtarët dhe trajnerët të cilët janë në bankinë duhet të bartin maskat gjatë gjithë kohës derisa nuk futen në ndeshje. Vetëm trajneri kryesor dhe lojtarët mund të qëndrojnë pa maskë, ndërsa stafi përcjellës i ekipit e kanë obligative vendosjen e maskës (mbi hundë).
- Në 10 vendet e siguruara për perçjellesit e klubit do të vendosen jashtë vijës fundore, në anën e kundërt të bankinës duke prezantuar dëshmitë nga Pika 1 dhe 2.




FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

#### - Banka e skuadrave

Lojtarët e bankës rezervë dhe stafi profesional duhet të respektojnë një distancë sigurie prej 1.5 m.

Stolat ose karriget për lojtarët duhet të vendosen në dy rreshta, njëra pas tjetrës ose në formën e shkronjës L.

#### BANKINAT E EKIPEVE GJATE MASAVE MBROJTËSE



Vetëm trajneri kryesor dhe lojtarët mund të qëndrojnë pa maskë, ndërsa stafi përcjellës i ekipit e kanë obligative vodosjen e maskës (mbi hundë).

#### 9. MASAT MBROJTËSE PAS PËRFUNDIMIT TË NDESHJES

- Të largoheni nga fusha e lojës sa më shpejtë që është e mundur.
- Të pastrohen thellësisht duart ose të shfrytëzohen mjetet dezinfektuese pas përfundimit të ndeshjes.



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

- Të shmanget pastrimi i trupit në dush-kabina (të ketë pastrim trupi në shtëpi).
- Të mos ketë aktivitete sociale në palestër.
- Të reduktohet numri i lojtarëve për intervista.
- Të pastrohen thellësisht peshqirët, çantat, pajisjet tjera të cilat janë përdorë për ndeshje.

## 10. MASAT NË RAST TË INFEKTIMIT ME COVID-19

- Në rast se ndonjë nga lojtarët, trajnerët, përcjellësit e klubit, personat zyrtarë rezultojnë pozitiv ndaj COVID-19 i njëjtë do të vet-izolohet dhe rikthimi i tij do të jetë e mundur pas testimit ndaj COVID-19 dhe i njëjtë të del negativ. Të gjithë akterët e ndeshjes para zhvillimit të ndeshjes tjetër janë të obliguar për tu testuar ndaj COVID -19 dhe të njëjtat duhet të deponohen në FBK.
  - Skuadra e cila mund të ketë lojtarë të infektuar nga COVID-19, ndeshjet e radhës do t'i zhvillojë me lojtarët të cilët pas testimit kanë rezultuar negativ ndaj testit COVID-19.
  - Skuadra e cila ka 1-4 lojtarë të rezultuar pozitivisht me COVID-19 dhe për këtë ka njoftuar FBK-në, duhet të paraqet faktet nga testimi të COVID-19 brenda 24 orëve të ardhshme. Lojtarët e infektuar do të izolohen, kurse lojtarët tjerë brenda 24 orëve të ardhshme duhet të testohen dhe të njëjtit në rast të rezultateve negative kanë të drejtë të paraqiten në ndeshjen e radhës. Kthimi i lojtarëve të infektuar do të jetë e mundur vetëm pas daljes së testit negativ të cilat duhet të deponohen në FBK më së paku 24 orë para zhvillimit të ndeshjes të radhës. Infektimi dhe izolimi i 1-4 lojtarëve, nuk është arsyё për mos zhvillimin e ndeshjes.
- Në rast se skuadrat nuk kanë dhe nuk paraqesin fakte të mjaftueshme (**rezultate të testimit, certifikatë mjekësore nga infektimi COVID-19**) me të cilat do të vërtetohet infektimi i lojtarëve me COVID-19 brenda 24 orëve dhe i njëjti klub nuk paraqitet në terminin e dhënë më herët për zhvillimin e takimit, ndeshja do të regjistrohet Konform Nenit 55.9 të Propozicioneve të Garave.

-FBK-ja ka laboratorin partner ku klubet mund të kryejnë testimet me çmimin e marrëveshjes në mes FBK-së dhe laboratorit i cili gjendet në Prishtinë, por rezultatet e testimeve do të pranohen edhe nga laboratorët nga qendrat tjera të cilat janë të licencuara nga Ministria e Shëndetësisë. Laboratori me anë të postës elektronike brenda 24 orëve është e obliguar të njoftojë FBK-në me rezultatet e testimeve.



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

- Skuadrat e Superligës në raste të mungesës së lojtarëve nga skuadra seniore në Listat Paraqitëse mund të paraqesin edhe lojtarët nga poligoni i tyre U18.
- Në rast se skuadra ka më tepër se 5 lojtarë të infektuar nga COVID-19, atëherë e gjithë skuadra do t'i nënshtronhet izolimit dhe kthimi i tyre do të jetë i mundur pas testimit ndaj COVID -19. Ndeshjet e klubit të basketbollit i cili komplet do të izolohet do të zhvillohen në terminet për të cilat do të vendosë FBK-së, pasi që janë testuar ndaj COVID-19.
- Basketbollistët e huaj të cilët paraqiten për regjistrim pranë FBK-së, janë të obliguar të paraqesin testimin/vaksinën ndaj Covid-19 para zhvillimit të ndeshjes. Ata mund të luajnë pasi të rezultojnë negativ.
- Për shkak të ndryshimeve dhe masave shtesë nga IKSHPK-ja, FBK ka të drejtë të plotësojë dhe të interpretojë Udhëzuesin, fillimisht duke marrë parasysh shëndetin e lojtarëve, trajnerëve dhe përcjellësve të skuadrave dhe për mos ndërprerjen e garave të basketbollit dhe gjithnjë duke respektuar masat mbrojtëse ndaj COVID-19.
- Udhëzimet mund të ndryshojnë varësisht nga situata me Covid-19 në Kosovë dhe rekomandimet nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës.

**VËREJTJE:** Ky Udhëzues mund të ketë masa shtesë varësisht nga situata dhe masat të cilat do t'i paraqesë Qeveria e Republikës së Kosovës.

Faton KURSHUMLIJA

Komesar i Garave

Elvira DUSHKU

Sekretare e Përgjithshme

Federata e Basketbollit të Kosovës